



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT
QENDRA E SHËRBIMEVE ARSIMORE

MODEL TESTI I MATURËS SHTETËRORE 2026

Lënda: Filozofi dhe Sociologji

Udhëzime për maturantin/kandidatin

Testi përmban gjithsej **60 pikë**.

Koha për zhvillimin e pyetjeve të testit është **2 orë e 30 minuta**.

Testi ka **20 pyetje** me **zgjedhje (alternativa)** dhe pyetjet e tjera janë me **zhvillim dhe arsyetim**.

Pikët për secilën pyetje janë dhënë përbri saj.

Për përdorim nga komisioni i vlerësimit

Pyetja	1	2	3	4	5	6	7
Pikët							
Pyetja	8	9	10	11	12	13	14
Pikët							
Pyetja	15	16	17	18	19	20	21
Pikët							
Pyetja	22	23	24	25	26	27	28
Pikët							
Pyetja	29	30	31	32	33		
Pikët							

Totali i pikëve

KOMISIONI I VLERËSIMIT

1. Anëtar

2. Anëtar

Sociologji

1. Në fund të shekullit XX, lëvizja "Protopunk" përfaqësonte një stil alternativ jetese, që kundërshtonte normat dhe pritshmëritë kryesore të shoqërisë. Kjo lëvizje krijoi një identitet jokonformist ndër radhët e anëtarëve të saj. Në terma sociologjikë, pjesëtarët e lëvizjes "Protopunk" për atë kohë përfaqësonin një: **1 pikë**
- A) kundërkulturë.
B) vlerë kulturore.
C) asimilim kulturor.
D) nënkulturë, por jo kundërkulturë.
2. Verorja, ndërthurja e fillit të bardhë dhe të kuq që vendoset në dorë si shenjë për ardhjen e pranverës, është pjesë e trashëgimisë kulturore botërore të UNESCO-s. Në sistemin kulturor, verorja përfaqëson: **1 pikë**
- A) vlerën.
B) gjuhën.
C) normën.
D) simbolin.
3. Koncepti "vetja shoqërore" sipas Midit, lidhet me zhvillimin e identitetit përmes ndërveprimit me të tjerët dhe vetëdijes për dallimin nga të tjerët. Koncepti "vetja shoqërore" shfaqet me: **1 pikë**
- A) lindjen e individit.
B) përvojën shoqërore.
C) brendësimin e përkatësisë gjinore.
D) tiparet e trashëguara të personalitetit.
4. Procesi i transmetimit të vlerave kulturore, mësimit të gjuhës amtare dhe përcjellja e elementëve të ndryshëm të kulturës quhet: **1 pikë**
- A) veçim.
B) asimilim.
C) shoqërizim.
D) etnocentrizëm.
5. Mjaft emigrantë meksikanë që jetojnë prej kohësh në SHBA kanë ndryshuar emrin dhe zakonet e të ushqyerit, duke u përshtatur me kulturën sunduese të vendit. Kjo marrëdhënie mes shumicës dhe pakicës lidhet me: **1 pikë**
- A) veçimin.
B) asimilimin.
C) shfarosjen.
D) pluralizmin.
6. Një kishë në Molenbeek të Belgjikës shtroi një iftar (darkë pas agjërit) për komunitetin mysliman gjatë muajit të Ramazanit. Bazuar në këtë situatë, përcaktoni funksionin kryesor të fesë. **1 pikë**
- A) Faktori i kontrollit shoqëror.
B) Përcaktimi i kuptimit të jetës.
C) Krijimi shoqëror i së shenjtës.
D) Toleranca dhe harmonia ndërfaqetare.
7. Anonimiteti e bën jetën shoqërore më pak të personalizuar. Ndonëse kontaktet sociale janë më të shpeshta, ato janë më kalimtare. Ky përshkrim është karakteristik kryesisht për: **1 pikë**
- A) fshatin.
B) mjedisin urban.
C) shoqërinë tradicionale.
D) revolucionin e parë urban.

8. “Në një botë të globalizuar, diskutimet për drejtësinë shoqërore dhe të drejtat e pakicave kanë fituar rëndësi të veçantë.”

Pohimi i mësipërm i referohet krijimit të profilit të shoqërisë:

1 pikë

- A) rurale.
- B) moderne.
- C) tradicionale.
- D) pasmoderne.

9. Cila formë e marrëdhënieve martesore është karakteristike për shoqërinë e kastave?

1 pikë

- A) Poliginia
- B) Poliandria
- C) Ekzogamia
- D) Endogamia

10. Studiuesja Margaret Hasluck jetoi për më shumë se një dekadë në Elbasan. Përgjatë qëndrimit me banorët e zonës, ajo studioi folklorin dhe traditat shqiptare. Gjetjet i botoi në librin “Ligjet e pashkruara të shqiptarëve”.

Bazuar në këtë rast, përcaktoni metodën e kërkimit që përdori studiuesja.

1 pikë

- A) Eksperimentin sociologjik
- B) Vëzhgimin pjesëmarrës
- C) Analizën e dokumenteve
- D) Intervistat e strukturuar

11. Bazuar në dy rastet e dhëna më poshtë nga kanuni, shpjegoni dy lloje të normave kulturore.

2 pikë

- 1. Në Kanunin e Lekë Dukagjinit përcaktohej se gruaja e ve mund të vazhdonte të jetonte në shtëpinë e burrit ose mund të kthehej në shtëpinë e prindërve të saj.
- 2. Në Kanunin e Lekë Dukagjinit përcaktohej se vajza nuk kishte tagër (të drejtë) të zgjidhte fatin e vet, por do të fejohej me atë që përcaktonin meshkujt e shtëpisë, me dëshirën apo pa dëshirën e saj. Për të lidhur fejesën, do të shihej paraprakisht që vajza të mos ishte gjak e gjini (lidhje gjaku, lidhje familjare) me atë që do të fejohej.

Udhëzuese

Tabu

12. Nxënësit e klubit të historisë kanë qenë pjesë e një vizite studimore që synonte promovimin e multikulturalizmit dhe shkëmbimit kulturor. Gjatë vizitës, nxënësit bashkëpunuan për një prezantim, duke përgatitur një material për vlerat, traditat dhe kulturën e vendit. Të gjithë nxënësit demonstruan qëndrime etike, tolerancë dhe respekt për larminë kulturore.

Bazuar në shembullin e dhënë, shpjegoni dy funksione që realizon shkolla në procesin e shoqërizimit.

2 pikë

- 1) _____
- 2) _____

13. Kuptimi për sjelljet deviante ndryshon nga njëra shoqëri në tjetrën, bazuar në normat kulturore, besimet, vlerat. Një model sjellje ose veshje që për një kulturë mund të konsiderohet e papërshtatshme ose rebele për një kulturë tjetër mund të jetë shprehje e individualitetit. Shpjegoni katër faktorë që ndikojnë në kuptimin relativ të deviancës. **4 pikë**

- 1) _____
- 2) _____
- 3) _____
- 4) _____

14. Fituesja e çmimit Nobel, feministja Maathai, përgjatë fjalimit të saj deklaroi: *“Sa më lart të shkoni (në hierarkinë shoqërore), aq më pak gra ka.”*

Bazuar në këtë citim, shpjegoni tre drejtime kryesore të pabarazisë ndërgjinore.

3 pikë

- 1) _____

- 2) _____

- 3) _____

15. Sociologët dallojnë mënyrën e organizimit shoqëror në fshat nga ajo në qytet. Sociologu Tënis përdor termin “shoqëri” për të karakterizuar mënyrën e jetesës në qytet. Analizoni tri veçori të mënyrës së jetesës në qytet që e dallojnë nga ajo në fshat. **3 pikë**

- 1) _____

- 2) _____

- 3) _____

16. Lëvizjet shoqërore janë organizime me natyrë sociale, politike etj., që luajnë rol të rëndësishëm në formësimin e politikave përgjatë historisë. Sociologu Frederik Miler ka analizuar dinamikën e lëvizjeve shoqërore dhe arsyet pse ato humbasin vulltin me kalimin e kohës. Analizoni tri arsye që, sipas Milerit, çojnë në rënien e lëvizjeve shoqërore. **3 pikë**

- 1) _____

- 2) _____

- 3) _____

17. Në shoqëritë moderne vihet re zbehja e forcës së traditës dhe mbizotëron zgjerimi i mundësive për zgjedhje vetjake e vetëshprehje.

Përshkruani tri mundësi që shoqëria moderne u ofron individëve për zgjedhje vetjake.

3 pikë

- 1) _____

- 2) _____

- 3) _____

Filozofi

18. Në shprehjen e Senekës: *“Nuk ka asgjë në botë që të admirohet aq shumë, sa një njeri që di si të përballojë palumturinë me kurajë.”*, shfaqen pikëpamjet e tij: **1 pikë**
- A) stoike.
B) skeptike.
C) epikuriane.
D) neoplatoniane.
19. Mark Aureli zbatonte parimet stoike dhe e vlerësonte filozofinë si udhërrëfyese për veprime të virtytshme në angazhimin e tij në: **1 pikë**
- A) politikë dhe qeverisje.
B) përvojën mistike dhe mitologjike.
C) vëzhgimin empirik të eksperimenteve.
D) retorikën me natyrë subjektive në të folurit publik.
20. Gjatë periudhës së Rilindjes, filozofia u ndikua nga fryma humaniste duke nxitur një qasje kritike ndaj autoritetit fetar dhe duke vënë në qendër të reflektimit arsyen. Cila nga alternativat e mëposhtme përshkruan më mirë zhvillimin e filozofisë në periudhën e Rilindjes? **1 pikë**
- A) Shkenca dhe arsyeja u kritikua.
B) Filozofia u çlirua nga paragjykimi dhe dogma.
C) Në qendër të mendimit filozofik qëndronte Zoti.
D) Veprat e filozofëve antik u harruan dhe u krijua një perspektivë tërësisht e re.
21. Cili nga pohimet e mëposhtme lidhur me njohjen, i përket drejtimit filozofik të empirizmit? **1 pikë**
- A) Njohja është më së shumti rezultat i dijes deduktive.
B) Njohja është burim i ideve të lindura, të cilat duhet t'i rikujtojmë.
C) Metoda eksperimentale dhe shqisat kanë përparësi në procesin e njohjes.
D) Metoda skeptike e Dekartit, si përfaqësues i këtij drejtimi, ka prioritet në njohje.
22. Shekulli XVIII u karakterizua nga ndryshime të mëdha historike dhe shoqërore, të ndikuara nga Revolucioni Francez e më gjerë. Cili ishte ndikimi i filozofisë iluministe në zhvillimet e kësaj periudhe? **1 pikë**
- A) Legjitimoi monarkinë absolute.
B) Mbështeti pushtetin e aristokracisë.
C) Forcoi besimin fetar kundrejt shkencës.
D) Nxiti mendimin kritik, lirinë dhe barazinë.
23. Hjum shprehej: *“Arsyeja është dhe duhet të jetë skllave e pasioneve e nuk mund të ketë kurrë, në asnjë rast, një funksion të ndryshëm nga të shërbyerit dhe të bindurit ndaj pasioneve.”* Sipas Hjumit, morali buron nga: **1 pikë**
- A) Zoti.
B) arsyeja.
C) ndjenjat.
D) intelekt.
24. Sipas Marksit, punëtori që zotëron vetëm forcën e krahut në rendin kapitalist: **1 pikë**
- A) pasurohet.
B) respektohet.
C) tjetërsohet.
D) vetërealizohet.

25. Zhan Zhak Ruso ishte filozofi iluminist që theksoi lidhjen mes pabarazisë shoqërore dhe lindjes së pronës private, e cila sipas tij solli: **1 pikë**
- A) harmoni mes njerëzve.
 - B) zhvillim dhe mirëqenie për të gjithë.
 - C) ndarjen në klasa dhe luftën mes tyre.
 - D) bashkëpunimin mes grupeve shoqërore.

26. Pyetja: *“Çfarë është me të vërtetë e dobishme për njeriun?”*, e cila përfaqëson një qasje filozofike praktike, bazuar në nxitjen e mirëqenies njerëzore, është karakteristike për drejtimin: **1 pikë**
- A) dialektik.
 - B) utilitarist.
 - C) pozitivist.
 - D) strukturalist.

27. Deklarata e Niçes se Zoti ka vdekur, ne e kemi vrarë atë, përfaqëson një perspektivë që kërcënon stabilitetin shoqëror. Për Niçen kjo situatë paraqet një: **1 pikë**
- A) mundësi për të ruajtur të gjitha vlerat morale.
 - B) sfidë për të krijuar vlera të reja që mund të udhëheqin botën.
 - C) sfidë për shpëtimin e shpirtit njerëzor dhe sigurimin e parajsës.
 - D) mundësi për të vepruar brenda kufijve, bazuar te tradita fetare.

28. Pikëpamjet filozofike të Sokratit kanë luajtur një rol të rëndësishëm në kultivimin e dyshimit për të vërtetën. Përkthyesi dy elementët e poshtëshënuar si hapa të cilët na çojnë drejt njohjes. **4 pikë**

Dialektika sokratike: _____

“Unë di, se nuk di asgjë”. _____

29. Në një epokë të orientuar drejt përparimit teknologjik, pritshmërive shoqërore, sfidave për sukses dhe pasigurive të ekzistencës, njerëzit e kanë të vështirë të gjejnë qetësi. Shpjegoni tri nga rrugët që sipas Epikurit, na ndihmojnë të jetojmë një jetë të qetë e të lumtur. **3 pikë**

- 1) _____
- 2) _____
- 3) _____

30. Mesjeta ishte një epokë e rëndësishme historike e filozofike, e cila karakterizohej nga tipare të veçanta që e dallojnë nga periudhat e tjera. Përkthyesi katër tipare kryesore të mendimit filozofik e realitetit në Mesjetë. **4 pikë**

- 1) _____
- 2) _____
- 3) _____
- 4) _____

31. Xhon Loku shprehej: *“Arsyeja pse njerëzit hyjnë në shoqëri (kontratë shoqërore) është ruajtja e pronës së tyre; dhe qëllimi pse ata zgjedhin dhe autorizojnë një organ legjislativ është që të mund të hartohen ligje dhe të vendosen rregulla si roje dhe gardhe për pronat e të gjithë anëtarëve të shoqërisë, për të kufizuar pushtetin dhe për të moderuar sundimin e çdo pjese dhe anëtari të shoqërisë.”*

Vlerësoni tri parime politike të Lokut të cilat kanë vlerë për një shoqëri demokratike.

3 pikë

- 1) _____

2) _____

3) _____

32. Për Haidegerin ekzistenca njerëzore na përball me peshën e përgjegjësisë. Ne jemi të hedhur në një botë të mbushur me mundësi, në të cilën duhet të zgjedhim dhe kjo situatë krijon ankth. Për filozofin, ankthi është gjendja shpirtërore themelore e ekzistencës. Analizoni, sipas perspektivës së Haidegerit konceptin e ankthit dhe përgjegjësisë.

2 pikë

Ankth

Përgjegjësi

Shprehni qëndrimin tuaj: Ekzistenca është proces zgjedhjesh vetjake.

1 pikë

33. Xhon Djuj shprehej: *“Arsimi nuk është një çështje e “të treguarit” dhe e të thënit, por një proces aktiv dhe konstruktiv.”*

Mbështetur në idetë e Djuj, formuloni dy argumente, se përse nevojitet një pedagogji dhe edukim praktik dhe jo autoritar.

2 pikë

- 1) _____

2) _____

Analizoni rolin e edukimit në ndryshimin e shoqërisë, sipas Djuj.

1 pikë

